



USAID
ОД АМЕРИКАНСКИОТ НАРОД



BUXHETI QYTETAR I KOMUNËS SË TEARCËS PËR VITIN 2023



Ky dokument është përgatitur si pjesë e Projektit të USAID-it për forcimin e kapaciteteve për shfrytëzimin e resurseve, me mbështetjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA për zhvillim ndërkombëtar (USAID).



BUXHETI QYTETAR I KOMUNËS SË TEARCËS PËR VITIN 2023

Ky dokument është përgatitur si pjesë e Projektit të USAID-it për forcimin e kapaciteteve për shfrytëzimin e resurseve, me mbështetjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA për zhvillim ndërkombëtar (USAID).

PËRMBAJTJA

pse buxheti qytetar? _____	3
CILAT JANË KOMPETENCAT E KOMUNËS? _____	4
ÇKA ËSHTË BUXHETI KOMUNAL DHE NGA ÇKA PËRBËHET? _____	4
KUSH JANË AKTIVITETET BUXHETORE QË I REALIZON KOMUNA JONË? _____	5
SI I GRUMBULLON KOMUNA TË HYRAT KOMUNALE? _____	5
CILAT JANË BURIMET KYÇE TË TË HYRAVE KOMUNALE? _____	7
SA TË HYRA TATIMORE PLANIFIKON TË MBLEDH KOMUNA? _____	8
TATIMET NË PRONË - E HYRË E RËNDËSISHME VETANAKE E KOMUNËS _____	9
TË HYRAT JOTATIMORE _____	10
CILI ËSHTË ROLI I TRANSFERTAVE NGA QEVERISJA QENDRORE-DOTACIONET? _____	11
KU DHE SI SHPENZOHEN PARATË KOMUNALE ? _____	12
SA PLANIFIKON TË SHPENZOJË KOMUNA PËR SECILËN NDARJE KOMPETENCË/PROGRAMË -SHËRBIM PËR QYTETARËT? _____	13
TË HYRAT DHE SHPENZIMET E KOMUNËS PËR KOKË-BANORI _____	18
SI REALIZOHET BUXHETI KOMUNAL? _____	19
DOKUMETET BUXHETORE KYÇE - si mundet qytetarët të përcjellin realizimin e buxhetit komunal? _____	22

PSE BUXHETI QYTETAR?

- ✓ Informimi i qytetarëve se si mblidhen të hyrat komunale dhe si shpenzohen mjetet komunale
- ✓ Edukimi i qytetarëve për termat kryesore, principet dhe parimet që lidhen me buxhetin komunal dhe financat lokale.
- ✓ Rritja e vetëdijes së qytetarëve për rolin e tyre në procesin buxhetor në nivel lokal.
- ✓ Nxitje dhe aktivitet në pjesëmarrjen më të madhe të qytetarëve në proceset e planifikimit dhe realizimit të buxhetit komunal.
- ✓ Njohja e qytetarëve me BUXHETIN e miratuar për vitin 2023 dhe karakteristikat e saj themelore - struktura - cilat janë dhe sa janë të hyrat komunale dhe ku planifikon komuna t`i shpenzojë burimet publike.

CILAT JANË KOMPETENCAT E KOMUNËS?

- Planifikimi urbanistik (urbane dhe rurale)
- Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës
- Zhvillimi ekonomik lokal
- Veprimtaritë komunale
- Kultura
- Sporti dhe rekreacioni
- Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve
- Arsimi
- Mbrojtja shëndetësore
- Mbrojtje dhe shpëtim
- Mbrojtja nga zjarri
- Mbikëqyrje e kryerjes së punëve nën kompetencat e saj
- Kompetenca të tjera të definuara me ligj

ÇKA ËSHTË BUXHETI KOMUNAL DHE NGA ÇKA PËRBËHET?

Buxheti i njësisë së qeverisjes lokale është një plan vjetor i të hyrave, të ardhurave të tjera dhe fondeve të miratuara dhe përfshinë buxhetin bazë, buxhetin e dotacioneve, buxhetin e donacioneve, buxhetin e kredive dhe buxhetin e veprimtarive vetëfinancuese. Buxheti i qeverisjes lokale demonstroi vlerat dhe prioritetet e pushtetit lokal. Buxhetimi dhe teknikat planifikimit financiar janë elemente kyçe në ruajtjen e integritetit fiskal të qeverisjes lokale.



KUSH JANË AKTIVITETET BUXHETORE QË I REALIZON KOMUNA JONË?

Kryetari dhe administrata komunale, me qëllim konsolidimin për nevojat e qytetarëve dhe për të përgatitur buxhetin komunal që do t'u përgjigjej nevojave dhe prioriteteve të identifikuara, iniciuan disa aktivitete si; duke vizituar zonat e banuara dhe duke diskutuar me qytetarët dhe bizneset për një konsolidim më specifik të prioriteteve të tyre buxhetore. Gjithashtu, Komuna ka një politikë të hapur për pjesëmarrjen e qytetarëve - në ditë të caktuara të javës çdo qytetar i komunës mund të vijë në ambientet e komunës dhe të ndajë idetë, nevojat dhe kërkesat e veta me personat përgjegjës në komunë dhe kryetarin e komunës.

SI I GRUMBULLON KOMUNA TË HYRAT KOMUNALE?


Sigurimi dhe mbledhja efikase e të hyrave komunale janë bazë për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve të nevojshme publike për qytetarët e komunës. Qëkëtu, më poshtë janë paraqitur (shuma e tyre, përqindja e pjesëmarrjes) buxheti bazë i komunës dhe "rrjedhat" kryesore shtesë të të hyrave në buxhetin komunal - të hyrat vetanake, dotacionet - pushteti qendror, donacionet, huamarrjet etj.

BUXHETI I KOMUNËS është plan vjetor i të hyrave, të ardhurave dhe mjeteve tjera të miratuara dhe i përfshinë buxhetin bazë, buxhetin e dotacioneve, buxhetin e donacioneve, buxhetin e kredive dhe buxhetin e aktiviteteve vetëfinancuese. Ndërsa, BUXHETI BAZË I komunës është plan vjetor i të hyrave, të të ardhurat e tjera dhe mjeteve të miratuara me buxhet për financimin e kompetencave bazë të komunës. DOTACIONI paraqet transfertë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe buxhetet e mjeteve në buxhetin e komunës. Donacionet janë mjete të destinuara kryekëput nga donatorët në bazë të një marrëveshjeje të lidhur. Veprimtaritë vetëfinancuese janë të ardhura vjetore të shfrytëzuesve buxhetorë që janë shtesë e aktiviteteve themelore ligjore.

Tabela 1. Të hyrat e Komunës (në denarë dhe struktura në %)

Llogaria e të ardhurave	Shuma	Struktura e të hyrave %
Buxheti themelor i komunës	98425582	38,67
Donacionet	0	0,00
Kreditet	0	0,00
Aktivitetet vetëfinancuese	1000000	0,39
Dotacionet	155095000	60,94
Gjithsej të hyrat	254520582	100

Grafiku 1. Struktura e të hyrave komunale sipas llojeve të llogarive (aspekt, forme, pamje) (në %)




CILAT JANË BURIMET KYÇE TË TË HYRAVE KOMUNALE?

TË ARDHURAT E KOMUNAVE në buxhet janë taksat dhe pagesat e tjera të detyrueshme, të cilat përcaktohen me ligj, të ardhurat që rrjedhin nga pronësia e mjeteve (interesat, dividendët, qiratë, etj.), kompensimi për mallrat ose shërbimet e ofruara, dhuratat, donacionet, sponsorizimet, subvencionet dhe transfertat. Rëndësi të veçantë kanë BURIMET VETANAKE TË TË ARDHURAVE të komunës, ku përfshihen taksat lokale, tatimet lokale dhe kompenzimet lokale, të hyrat nga prona e komunës, vetëkontributi, gjobat në të holla, donacionet dhe të hyrat e tjera të konsoliduara me ligj. Në vazhdim janë paraqitur burimet kryesore të të hyrave që komuna planifikonë të sigurojë në vitin 2023. Shuma më e madhe e të hyrave do të sigurohet nga taksat komunale për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, ndërsa gjithashtu shuma përkatëse e të hyrave do të sigurohet edhe nga 15.006.480,00 denarët. Në strukturën e të hyrave kryesore, pjesën më të madhe e zënë transfertat dhe donacionet, 53,889,415,00 me 54,20%, ndërsa të hyrat nga taksat zënë 37,736,167,00 me 37,95%, të hyrat jotatimore me 3,470,000,00 me 3,470,000,00 me 3,049%, dhe të hyrat kapitale me 3,04% me 3,40%.

Tabela 2. Të hyrat kyçe të komunës në pajtim me klasifikimin ekonomik (shuma në denarë dhe struktura në %).

Forma e të hyrave	Shuma	Pjesëmarrja në të hyrat totale në %
Të hyrat tatimore	37736167	37,95
Të hyrat jotatimore	3470000	3,49
Të hyrat kapitale	4330000	4,36
Transfertat dhe donacionet	53889415	54,20
Gjithsej	99425582	100,00

Grafiku 2. Struktura e të hyrave komunale sipas klasifikimit ekonomik (në %)



SA TË HYRA TATIMORE PLANIFIKON TË MBLEDH KOMUNA?


Të hyrat tatimore janë pjesa themelore dhe më e rëndësishme e të hyrave vetanake të komunës, andaj më poshtë ju paraqesim shumën e të hyrave tatimore që komuna planifikon të mbledhë në vitin e ardhshëm. Gjithashtu është paraqitur struktura që tregon se cilat të hyra tatimore planifikohet të kenë pjesëmarrjen më të madhe në të hyrat komunale.

Tabela 3. Të hyrat tatimore kyçe të komunës (shuma në denarë dhe struktura ne %)

Llojet e të hyrave tatimore	Shuma	Pjesëmarrja në të hyrat tatimore %
Shpenzimet për rregullimin e tokës ndërtimore	4500000	11,92
Taksa komunale për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik	1500648	0
Tatimi qarkullues i patundshmërive	6500000	17,22
Tatimi në pronë nga personat fizikë	3500000	9,27
Tatimi në pronë nga personat juridikë	400000	1,06
Tatimi I trashëgimisë dhe dhuratës	1800000	4,77
Të hyra tjera tatimoe	6029687	15,98
	3773616	
Gjithsej	7	100

Komuna planifikon të sigurojë më së shumti të hyra nga tatimi për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, ndërsa pjesën më të vogël të të hyrave tatimore e zë tatimi në pronë nga personat juridikë.

Grafiku 3. Të hyrat tatimore të Komunës së Tearcës (në denarë)




TATIMET NË PRONË - E HYRË E RËNDËSISHME VETANAKE E KOMUNËS

Tatimi pronësor është një nga burimet më të rëndësishme të të hyrave vetanake të komunës. Struktura e planifikuar për vitin 2023 e llojeve të veçanta të tatimit pronësor është paraqitur më poshtë.

Proporcionin më të lartë të të ardhurave e zë tatim-qarkullimi i patundshmërive me të drejtë pjesëmarrjeje prej 53% në vlerën totale të tatimeve pronësore.

Grafiku 4. Struktura e tatimeve në pronë në totalin e të hyrave sipas tatimit bazë në pronë të Komunës së Tearcës (në %) □




TË HYRAT JOTATIMORE

Të hyrat jotatimore të cilat, komuna planifikon t'i mbledh për vitin 2023 janë të paraqitura në vazhdim. Shuma më e madhe e të hyrave jotatimore duhet të jenë të siguruara nga gjobat, tarifat gjyqësore dhe administrative, kurse proporcioni më i ulët pritet të të hyrat tjera jotatimore me 20.65%.

Tabela 4. Llojet e të hyrave jotatimore (shuma në denarë dhe struktura në %)

Forma e të hyrave jotatimore	Shuma	Pjesëmarrja në total e të hyrave jotatimore %
Gjobat, tarifat gjyqësore dhe administrative	1160000	46,96
Të hyrat nga qiramarrja e pronës komunale	800000	32,39
Të hyrat jotatimore shtesë	510000	20,65
Gjithsej	2470000	100


Grafiku 5. Format e të hyrave jotatimore (struktura në %)



CILI ËSHTË ROLI I TRANSFERTAVE NGA QEVERISJA QENDRORE- DOTACIONET?

Vlefshmëria e formave kryesore të transfertave nga qeverisja qendrore është theksuar më poshtë. Shuma më e madhe e transfertave është e planifikuar për bllok-dotacionet në vlerë prej 155.095.000,00, por, shuma planifikuese e transfertës nga TVSH-ja vlerësohet 30.154.183,00, a për transfertat kapitale 6.893.079,00 denarë

Grafiku 6. Format e transfertave dhe donacioneve (në denarë)



Blok-dotacionet janë kompetencat e bartura nga pushteti qendrore dhe janë shumat më të rëndësishme të transfertave të cilat i fiton komuna dhe me të cilën në pjesën më të rëndësishme financohen kompetencat e bartura për arsimin. Shuma më e madhe e bllok-dotacioneve i referohet arsimi fillor dhe marrin pjesë në strukture më 100%

Tabela D.3. Struktura e burimimeve të shpenzimeve për arsim

Destinimi	Buxheti themelor	Donacionet	Aktivitetet vetëfinancuese	Dotacionet	Gjithsej
Arsimi fillor	0	0	0	155095000	155095000
Gjithsej	0	0	0	155095000	155095000


KU DHE SI SHPENZOHEN PARATË KOMUNALE?

Është e rëndësishme ku dhe si shpenzohen resurset lokale. Shpenzimet lokale janë të lidhura drejtpërdrejtë me sigurimin e nevojave dhe shërbimeve të qytetarëve-për atë strukturë të tyre dhe mënyra e shpërndarjes është veçanërisht e rëndësishme të jenë transparente. Në vazhdim janë të paraqitura shpenzimet kryesore të komunës për vitin 2023.

Shpenzimet më të mëdha në periudhën e ardhshme do të shpenzohen për paga dhe shpenzime në shumë prej 170.549.282 denarë, gjegjësisht 67,01% nga strukturë e shpenzimeve të përgjithshme, më tutje, mallra dhe shërbime në vlerë prej 53.496.204,00 denarë, gjegjësisht 21% prej shpenzimeve totale. Komuna e ndanë shumën më të ulët të shpenzimeve për përfitime sociale, me pjesëmarrje prej 0,22% në totalin e shpenzimeve të komunës 254.520.582,00. Në vitin 2023 shpenzimet kapitale janë parashikuar të arrijnë në 26.479.096,00 denarë, përkatësisht do të marrin pjesë me 10,4%. Në strukturën e totalit të shpenzimeve. Pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale janë planifikuar për realizimin e objekteve të tjera ndërtimore - ndërtimin e rrugicave, rrugëve dhe autostradave.

Shpenzimet në llogari	Shuma	Struktura
Paga dhe kompenzime	170549282	67,01
Rezerva dhe shpenzime të padefinuara	900000	0,35
Mallra dhe shërbime	53496204	21,02
Subvencione dhe transferta	2546000	1,00
Përfitime sociale	550000	0,22
Shpenzime kapitale	26479096	10,40
Gjithsej shpenzime	254520582	100

Grafiku 9. Struktura e shpenzimeve të Komunës së Tearcës sipas klasifikimit ekonomik (në %)





SA PLANIFIKON TË SHPENZOJË KOMUNA PËR SECILËN NDARJE KOMPETENCË/PROGRAMË -SHËRBIM PËR QYTETARËT?

Në vazhdim janë të theksuara planet kyçe për destinimet/shpërndarjet e mjeteve komunale për secilën nga kompetencat-shërbimet, të cilat duhet t'i marrin qytetarët. Shuma më e madhe e shpenzimeve nga llogaria komunale është e ndarë për arsimin fillor në vlerë prej 156.095.000,00 denarë, ndërsa më e ulëta për programet zhvillimore

Tabela 6. Shpenzimet totale të Komunës së Tearcës sipas njësive kompetente (në denarë dhe struktura në %)

Shpenzimet totale të komunës sipas njësive kompetente	Shuma	Pjesëmarrja në shpenzimet totale (në %)
A – Këshilli komunal	4420000	1,74
D – Kryetari i Komunës	3485000	1,37
E – Administrata komunale	51437582	20,21
F – Planifikimi hapësinor	3000000	1,18
J – Veprimtari komunale	35200000	13,83
K - Kulturë	200000	0,08
L – Sport dhe rekreacion	300000	0,12
M – Programe për zhvillim	60000	0,02
N - Arsimi	156095000	61,33
R – Mbrojtja e mjedisit jetësor	250000	0,10
X – Barazi gjinore	73000	0,03
Gjithsej	254520582	100

Grafikon D,6. Shpenzimet kapitale të komunës sipas njësive kompetente




Shpenzimet e ndara për administratën komunale janë 51.437.582,00 denarë, të njëjtat për shërbime komunale janë të destinuara 2.550.000,00 denarë, për materiale zyre 1.700.000,00 denarë, si dhe për blerjen e orendive administrative, pajisje, softverë kompjuterikë 2.550.000,00 denarë.

Shpenzimet sipas kompetencave programore – administrata komunale (në denarë dhe struktura ne %)

Administrata komunale	Shuma	Pjesëmarrja në shumën totale sipas kësaj kompetence (në %)
EO – Administrata komunale	48887582	95
EA – Harxhimet kapitale të komunës	2550000	5
Gjithsej	51437582	100

Grafikoni D.7. Shpenzimet sipas kompetencave programore- Administrata komunale



■ EO - Administrata komunale ■ EA -Harxhimet kapitale të komunës

Shpenzimet e përgjithshme që janë të destinuara për punën e kryetarit kapin shumën prej 3.485.000,00 denarë dhe përfshijnë 1.125.000,00 denarë për paga dhe kompenzime të kryetarit, 900.000,00 denarë rezerva rrjedhëse e kryetarit, 350.000,00 denarë për mallra dhe shërbime, 560.000,00 denarë për transferata, 550.000,00 për benefite sociale. Në shpenzimet sipas kompetencës së programeve të urbanizmit dhe planifikimit urbanistik shuma më e madhe ndahet për shërbimet Kontraktuese për planifikimet Urbanistike ku janë të planifikuara/ndara 3.000.000,00 denarë, të cilat kanë për qëllim përkrahjen e këtyre aktiviteteve: planit urbanistik për fshat dhe planit urbanistik jashtë vendbanimit

Tabela 8. Shpenzimet sipas kompetencës së programeve - Urbanizëm/planifikim urbanistik (shuma në denarë dhe struktura në %)

Planifikimi urbanistik	Shuma	Pjesëmarrja në shpenzimet totale nga kjo kompetencë
Ф1 – Planifikimi urbanistik	3000000	100
Вкупно	3000000	100

Shpenzimet e ndara për shërbimet komunale në shumë prej 35.200.000,00 denarë, kanë si qëllim të ndihmojnë aktivitetet, si: mirëmbajtjen dhe sigurimin e rrugëve lokale, rrugicave dhe rregullimin e rendit të komunikacionit prej 1.600.000,00 denarë, furnizimin me ujë 500.000,00 denarë, ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugicave dhe rrugëve lokale 21.600.000,00 denarë, mirëmbajtja e ndriçimit publik 10.000.000,00 denarë si dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta etj.

Tabela 9. Shpenzimet sipas kompetencës së programeve – veprimtaritë komunale (shuma në denarë dhe struktura në %)

Shërbimet komunale	Износ	Pjesëmarrja në shpenzimet totale sipas kompetencës (në %)
J1-Furnizimi me ujë	500000	1,42
J3-Ndriçimi publik	1000000	28,41
J6-Sigurimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale, rrugicave dhe rregullimi i rendit të komunikacionit	1600000	4,55
J8-Shërbime të tjera komunale	1500000	4,26
ЈД-Ndërtimi dhe rikonstruimi rrugëve dhe rrugicave lokale	2160000	61,36
Gjithsej	3520000	100,00

	Projekte për vitin 2023	Afati i fundit për realizim	Shuma (MKD)	Përdoruesit potencialë
1	Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugës lokale në f. Tearcë P1203 - железничка станица stacioni I vjetër hekurudhor (pjesë)	11/1/2023	1,500,787	Fermerët, sektori i biznesit, banorët e f. Tearcë etj.
2	Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugës lokale në f. Glllogjë	11/1/2023	4,000,000	Banorë të f. Glllogjë dhe vendbanimet përreth, fermerët, nxënësit etj
3	Rikonstruimi i ujëgrumbulluesit (kaptazhës) – f. Dobrosht	11/1/2023	1,392,292	Banorë të f. Dobrosht, nxënësit, personat në moshë etj

Gjithsej 6,893,079

Në shpenzimet për mbrojtjen e ambientit jetësor në komunën e Tearcës mbizojtërojnë shpenzimet për hapësira të gjelbërta të reja.

Tabela D.5. Shpenzimet sipas kompetencës(rëndësisë) së programeve – Mbrojtja e mjedisit jetësor


Mbrojtjen e mjedisit jetësor	Vlera (në den)	Përmbajtja në shpenzimet totale e kësaj kompetence (në%)
P1-Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës	250000	100
Gjithsej	250000	100

Sa i përket mjeteve të planifikuara për realizimin e aktiviteteve kulturore, të njëjtat mund të ndahen në, aktivitete që kanë të bëjnë me manifestimet kulturore __ Mbështetje financiare për manifestimin për mërgimtarët "TEARCA FESTON ME KURBETÇINJTË", në f. Tearcë, në shumë prej 60.000,00 den, dhe manifestime të tjera kulturore.

Tabela D.7. Shpenzimet sipas kompetencës(rëndësisë) së programeve - Kultura

Kultura	Vlera (në den)	Përmbajtja në shpenzimet totale e kësaj kompetence (në%)
K4-Manifestimet kulturore dhe veprimtari	200000	100
Gjithsej	200000	100

Grafikoni 13. Shpenzimet sipas kompetencës së programeve – Kultura (pjesëmarrja në %)




Shpenzimet për sport dhe rekreacion, para së gjithash, janë të dedikuara, për Mjete për mirëmbajtjen e stadimeve në Komunën e Tearcës në vlerë prej 100.000,00 denarë, ndarje të mjeteve për klube sportive dhe mbështetje financiare për sportistë të talentuar dhe ngjarje sportive, në vlerë prej 200.000,00 denarë.

Tabela D.8. Shpenzimet sipas kompetencës së programeve – Sport dhe rekreacion

Sport dhe rekreacion	Shuma	Struktura
L0-Sport dhe rekreacion	300000	100
Gjithsej	300000	100

Grafiku 14. Shpenzimet sipas kompetencës së programeve – Sport dhe rekreacion (pjesëmarrja në %)



Shpenzimet e ndara për barazi gjinore arrijnë në 73.000,00 denarë, që është 0,08% nga buxheti i përgjithshëm i ndarë në programin për mundësi të barabarta. (këtu komuna citon konkretisht nëse ka/ndërmerr masa (aktivitete) të tjera gjinore në kuadër të programeve të tjera, thekson se cilat janë ato programe/masa/aktivitete)


Tabela 10 – Shpenzimet sipas kompetencës së programeve – Barazi gjinore (në denarë dhe struktura në %)

Mbrojtja zjarrfikëse	Shuma	Pjesëmarrja në shpenzimet totale e kësaj kompetence (%)
X-Barazia gjinore	73000	100
Gjithsej	73000	100

TË HYRAT DHE SHPENZIMET E KOMUNËS PËR KOKË-BANORI

Në vitin 2023, të hyrat për kokë-banori në komunën e Tearcës do të jenë 5.563,00 denarë, që paraqet rritje prej 17% në krahasim me shumën e tyre në vitin 2022.

Grafiku 17. Të hyrate e komunës për kokë-banori (në denarë)





SI REALIZOHET BUXHETI KOMUNAL?

Realizimi i buxhetit komunal është një tregues i rëndësishëm që lidhet me realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara në periudhën e kaluar. Gjithashtu, tregon realizimin/trendin e pritur të realizimit të buxheteve komunale. Në vijim tregohet realizimi i buxhetit bazë (zotërues) të komunës dhe buxhetit të përgjithshëm të komunës si në aspektin e të hyrave ashtu edhe në aspektin e shpenzimeve. Realizimi i të hyrave vetanake në periudhën 2018-2022 tregon trend rritës. Të hyrat e përgjithshme të komunës së Tearcës në vitin 2022 arritën në 226.261.554,00 denarë, që do të thotë rritje prej 15% në krahasim me vitin 2021

Tabela 11. Të hyrat e planifikuara dhe të realizuara të komunave

Llogaria hyrëse	Buxheti themelor			E hyra totale		
	Shuma e planifikuar	Shuma e realizuar	Realizimi në %	Shuma e planifikuar	Shuma e planifikuar	Realizimi në %
Viti						
2022	84210551	87951474	104	224998616	226261554	101
2021	79752834	67236355	84	214704834	197094219	92
2020	82631376	64869226	79	213788051	189541226	89
2019	93506425	65932031	71	206680425	176022031	85
2018	117875600	60649987	51	227208316	166655987	73

Grafiku 18. Të hyrat totale të planifikuara dhe të realizuara dhe të hyrat nga buxheti themelor për periudhën 2018-2022 (në denarë dhe struktura në %)





Realizimi i shpenzimeve totale të komunës së Tearcës në vitin 2022 është 97%, që paraqet një rritje prej 6 pikë-përqindjeje krahasuar me vitin 2021.

Shpenzimet totale shënuan një rënie prej 10.70% pikë-përqindjeje.

Tabela 12. Shpenzimet totale të planifikuara dhe të realizuara dhe shpenzimet nga buxheti themelor për periudhën 2018-2022

Llogaria dalëse	Buxheti themelor			Shpenzimi total		
Viti	E planifikuar	E realizuar	Realizimi vo %	E planifikuar shuma	E realizuar shuma	Realizimi në %
2022	84210551	80786282	96	224998616	219029076	97
2021	79752834	67236355	84	214704834	195593529	91
2020	82631376	58186858	70	213788051	181460825	85
2019	93506425	65932031	71	206680425	173587979	84
2018	117875600	60452929	51	227208316	164296122	72

Grafiku 19. Shpenzimet totale të planifikuara dhe të realizuara nga buxheti themelor për periudhën 2018-2022 (në denarë dhe struktura në %)



DOKUMENTET BUXHETORE KYÇE - si mundet qytetarët të përcjellin realizimin e buxhetit komunal?

Cilat janë dokumentet buxhetore kyçe?

- **Kalendari Buxhetor** përcakton afatet për planifikimin e buxhetit të përgjithshëm, ku do të përfshihen aktivitetet e lidhura me përgatitjen e buxhetit, realizimi i buxhetit sipas raporteve financiare ose ndjekja e realizimit të buxhetit nga administrata komunale.
- **Qarkulluesi buxhetor** përmbanë udhëzimet për përpunimin e propozim-buxhetit nga ana e përdoruesve buxhetorë dhe i dorëzohet Ministrisë së financave
- **Propozim-buxheti** përgatitet nga kryetari i komunës (administrata komunale) në të cilin planifikohen të hyrat vjetore dhe shpenzimet vjetore dhe i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Komunës.
- **Propozim-plani i programeve për zhvillim** përmbanë projeksionet afatmesme të mjeteve të miratuara sipas njësive buxhetore, programeve dhe nënprogrameve, vitët që ato do të realizohen dhe burimet të financimit, përkatësisht buxhetet.
- **Buxheti** është akt i pushtetit lokal me të cilin, planifikohen të hyrat vjetore dhe shpenzimeve tjera dhe miratohen shpenzimet vjetore dhe të dalat tjera të shtetit ose të komunës.
- **Raportet mujore** i përmbajnë të dhënat e përgjithshme operative-rrjedhëse të të hyrave dhe shpenzimeve kapitale të muajit paraprak me të cilat lidhet periudha e raportimit.
- **Raporti kuartet K1** i përmbanë të dhënat e përgjithshme operative-rrjedhëse të të hyrave dhe shpenzimeve kapitale të tre muajve paraprakë për të cilën ka të bëjë periudha raportuese, në pajtim me klasifikimin ekonomik të të hyrave dhe shpenzimeve sipas llogarive dhe përmbledhjes
- **Raporti kuartet K2** i përfshijnë të dhënat për të gjithë detyrimet e pashlyera, si dhe detyrimet e pashlyera sipas llojeve dhe pikëpamjeve, me gjendjen e ditës së fundit nga kuarteti paraprak.
- **Raporti kuartet K3** i përmbanë të dhëna për huamarrjen dhe informacione për ndryshimet në gjendjen e secilës huamarrje në kuartetin paraprak, si dhe ndryshimet në gjendjen e garancive të lëshuara dhe të dhëna për borxhin e ndërmarrjeve publike që janë themeluar nga komunat.
- **Raporti gjysmëvjetor** përmbanë të dhënat e përgjithshme operative-rrjedhëse, të hyrat dhe shpenzimet kapitale për gjashtë muajtë paraprakë me të cilat lidhet periudha e raportimit.
- **Raporti vjetor** përmbanë të dhënat operative-rrjedhëse totale, të hyrat dhe shpenzimet kapitale për një vjet me të cilat lidhet periudha e raportimit.